



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.08.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Lulzim Beqiraj B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac “ , **Nr. i prokurimit- 632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521, nxjerr:**

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik **Lulzim Beqiraj B.I.** e dt.18.08.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac “ , **Nr. i prokurimit- 632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521**, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 15.08.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Përmirësohet pjesërisht DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË** , i publikuar me datë: 15.08.2022;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik **Lulzim Beqiraj B.I**, me dt.**18.08.2022**, ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac “ , Nr. i prokurimit- 632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 23.08.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik **Lulzim Beqiraj B.I** , të dt.**18.08.2022**, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishtëm e dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit